



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 28 shkurt 2018, në orën 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-1-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Shqipe Pantina, Andin Hoti, Ali Lajçi, Avdullah Hoti, Muharrem Nitaj dhe Mërgim Lushtaku.

Munguan: Verica Çeraniq, Faton Topalli, Zafir Berisham dhe Albert Kinolli.

Stafi mbështetës i komisionit: Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit tjerë: Vlora Spanca, Bujar Bajraktari, Valbon Bytyqi, Elvin Mala dhe Labinot Sadiku, ZKA.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 07.02.2018;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i amendamenteve për Projektligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr.06/L-021;
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për raportin e auditimit për PVF-të e SHSKUK-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016;
6. Shqyrtimi i raportit të performancës për Efikasitetin dhe Efektivitetin në Implementimin e Sistemit Informativ unik të Integruar Shëndetësor;
7. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 07.02.2018

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 07.02.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i amendamenteve për Projektligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr.06/L-021

Kryetari, theksoi se KMFP në punëtorinë e organizuar në Villa Gërmia ku ishin prezent edhe përfaqësues të institucioneve relevante lidhur me këtë çështje. Meqenëse kemi konsiderua që kemi krye punë të mjaftueshme për ti proceduar tutje amendamentet për projektligjin, nuk kemi nevojë të vonohemi më shumë. Ne sot mund ti aprovojmë të gjitha këto amendamente të cilat janë propozuar në takimin e fundit dhe ti procedojmë me pas për komisione të cilët e kanë obligim edhe me rregullore që ti trajtojnë këto amendamente. Kryetari hodhi në votim amendamentet për Projektligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe u përkrah unanimisht nga komisioni.

Përfundim

KMFP vendosi që amendamentet për Projektligjin për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike nr.06/L-021, të dërgohen te komisionet e përhershme për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016

Kryetari njoftoi deputetët se Ministri i Shëndetësisë, z. Uran Ismajli, për shkak të agjendës nuk do të jetë prezent në këtë takim, andaj pa prezencën e Ministrit, nuk mund ta shqyrtojmë raportin.

Përfundim

KMFP vendosi që shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 të bëhet në mbledhjen e radhës të komisionit.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për raportin e auditimit për PVF-të e SHSKUK-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016

Kryetari njoftoi deputetët dhe të pranishmit se raporti i auditimit për SHSKUK për vitin 2016 është shqyrtuar në mbledhjen e mëparshme të komisionit, prandaj sot do të diskutohet vetëm për rekomandimet të cilat i ka përgatitur stafi mbështetës i Komisionit, se bashku me deputetin raportues. Me këtë hapi diskutimin. Pasi nuk pati diskutim për këtë pikë Kryetari lexoi rekomandimet për SHSKUK-në të cilat ishin: SHSKUK në afatin kohor prej 1 muajsh të përgatitë planin e veprimit për adresimin e të gjitha rekomandimeve të dhëna nga raporti i auditimit për PVF-të e SHSKUK-së për vitin 2016, duke caktuar personat përgjegjës dhe afatet kohore, në veçanti për këto të gjetura: 1. Bordi drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së duhet të sigurojnë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV-ve 2017 i ka adresuar të gjitha çështjet e identifikuara. 2. Bordi drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së duhet të sigurojnë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP-ja. 3. Bordi drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së duhet të sigurojnë se është rishikuar procesi i plotësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë aktive. 4. Bordi drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së duhet të bëj përpjekje për të rritë kapacitetet në kuadër të NJAB-së, në mënyrë që të arrijë përfitimin maksimal nga aktivitetet e tyre. 5. Bordi drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së duhet të sigurojnë që janë ndërmarrë masat e duhura për përmirësimin e formës aktuale të menaxhimit të të hyrave, përfshirë përcaktimin e një zyrtari të të hyrave në kuadër të ShSKUK-së, dhe të shtohen përpjekjet për të funksionalizuar modulën e të hyrave në kuadër të SISH-it. 6. Bordi drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së duhet të sigurojnë që të gjitha njësitë e ShSKUK-së kanë forcuar kontrollin ndaj procesit të aprovimit, evidentimit dhe kompensimit të kujdestarive-ndërrimeve të natës, në mënyrë që të sigurohet se raportet mujore që procedohen për pagesë janë të bazuara në ditarët e kujdestarive. 7. Bordi drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm i ShSKUK-së duhet të sigurojnë se është kryer një rishikim i formës aktuale të raportimit për procesin e shpërndarjes së barnave.

Përfundim

KMFP vendosi që këto rekomandime ti adresohen menaxhmentit të SHSKUK-së, që në afatin prej 1 muaji të përgatitet plani i veprimit për adresim të rekomandimeve..

6. Shqyrtimi i raportit të Përformancës për Efikasitetin dhe Efektivitetin në Implementimin e Sistemit Informativ unik të Integruar Shëndetësor

Kryetari njoftoi deputetët se ministri i Shëndetësisë, z. Uran Ismajli, për shkak të agjendës nuk do të jetë prezent në këtë takim, andaj pa prezencën e ministrit, nuk mund ta shqyrtojmë raportin.

Përfundim

KMFP vendosi që Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Shëndetësisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 të bëhet në mbledhjen e radhës së komisionit.

7. Të ndryshme.

Kryetari Ne jemi pajtuar që të thërrasim këto dy institucione në raportim, Ministrinë e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Rektorin e Universitetit të Prishtinës (UP).

Andin Hoti, Unë kam përgatitur konkluzionet e raportit të MASHT dhe UP, tani mbetet që administrata të ftoj Ministrin dhe Rektorin, dhe në mbledhjen e radhës të trajtojmë raportin e auditorit të jashtëm për MASHT dhe UP.

Përfundim

KMFP vendosi që në mbledhje e radhës së Komisionit me 07.03.2018 të shqyrtoi Raportin e Auditimit të PVF-ve për vitin 2016 për MASHT dhe UP.

Kryetari theksoi se para disa ditëve Kryesia e Kuvendit me një shkresë përcjellëse ka ngarkuar KMFP-në për shqyrtimin e Projektligjit nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar, dhe për këtë duhet komisioni të vendos se a do të merremi me këtë projektligj apo është jashtë fushëveprimit të vetë komisionit. Pasi që nuk është në fushëveprim të KMFP dhe në këtë rast gabimisht jemi ngarkuar si komision funksional. Me këtë hapi diskutimin.

Avdullah Hoti: Projektligji nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim me të cilin rregullohet sistemi i kontabilitetit dhe i raportimit financiar i shoqërive tregtare, kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar (KKRF), kërkesat për auditim, kualifikimet për kontabilistë profesional, licencimi i auditorëve dhe firmave vendore e të huaja të auditimit, si dhe organizatat profesionale të kontabilitetit. Dispozitat e këtij Ligji janë të obliguar për të gjitha shoqëritë tregtare të regjistruara dhe të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës, sipas legjislacionit në fuqi. Dispozitat e këtij Ligji nuk zbatohen për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe të gjitha organizatat e licencuara nga BQK-ja, sipas legjislacionit në fuqi. Prandaj mendoj se Projektligj nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim është jashtë fushëveprimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Ky Projektligj duhet të shqyrtohet nga komisionin për buxhet dhe Financa. Ndoshta administrata e kuvendit e ka drejtuar gabimisht pa e pa ne detaje, Unë sugjeroj në pajtim me koleget të kthehet në Kryesi të Kuvendit, dhe pastaj të kaloj në Komisionin për Buxhet e Financa. Në legjislaturën e IV kur është punuar në Ligjin nr. 04/L-014 komisioni funksional ishte Komisioni për Buxhet e Financa.

Shqipe Pantina, po ashtu pajtohem se ky projektligj nuk përkon me fushëveprimi i komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, mirëpo mendoje se deputetët e KMFP-së mund të marrin pjesë aktive në amendamentimin e këtij projektligji edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa, në pjesën ku flitet për auditimin e pasqyrave financiare të Shoqërive Tregtare.

Kryetari Bazuar në fushëveprimin e KMFP-së si dhe nga praktika në legjislaturën e IV kur është punuar Ligji 04/L-014, komisioni funksional ka qenë Komisioni për Buxhet e Financa. Tani mendojë se prapë KBF duhet të merret me amendamentimin e Projektligji nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, dhe Kuvendit ti paraqes raport me rekomandime, ndërsa deputete e interesuar nga KMFP mund të japin kontributin e tyre në KBF.

Përfundim

Projektligji nr.06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim nuk mund të shqyrtohet në Komisionin për Mbikëqyrjen të Financave Publike përkundër shkresës së datës 15.01.2018 me të cilën është ngarkuar KMFP gabimisht për shqyrtim. Kjo bazuar në fushëveprimin e KMFP-së të dhënë me Rregulloren e Punës së Kuvendit si dhe Rregulloren e punës së Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:20.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj